



## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri i NSH</b>	NSH "Ndërmarrja e pyjeve" Suharekë ("Ndërmarrja")
<b>Emri i Ndërmarrjes së Re</b>	<b>Ndërmarrja e Re Pylltaria – Ndërtesa Administratës Suharekë SH.P.K.</b> ("Ndërmarrja e Re")  Ndërmarrja e Re e ofruar për shitje përfshin vetëm objektin e përshkruar si me poshtë.
<b>Vendndodhja</b>	Suharekë
<b>Biznesi/Spektori</b>	Pylltaria
<b>Prodhimet</b>	Ndërmarrja ka qenë e angazhuar në drejtimin e menaxhimit të pyjeve duke përfshirë planifikimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve. Mirëpo, që prej dy vitesh të gjitha këto aktivitete të përshkruara si më lartë i janë transferuar Agjencionit Pyjor të Kosovës (APK).
<b>Tregu</b>	Me investime plotësuese dhe bazuar në zhvillimin e pylltarisë në Kosovë ekziston mundësia për zgjerimin e biznesit.
<b>Konkurrenca</b>	Nuk ka konkurrencë vendore.
<b>Punonjësit</b>	Asnjë punonjës i NSH-së nuk kalon në Ndërmarrjen e Re të tenderuar.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	Ndërmarrja e Re Pylltaria – Ndërtesa Administratës Suharekë SH.P.K. Përbëhet nga Ndërtesa e Administratës dhe oborri. Ndërtesa përfshinë sipërfaqen përafërsisht prej 251 m <sup>2</sup> , ndërsa oborri 3093 m <sup>2</sup> me vendndodhje në Suharekë. Prona e Ndërmarrjes së Re Pylltaria – Ndërtesa e Administratës është e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-72116046-02992-0-411, Ngastra 2292 në emër të NSH-së. Parcela 2292 ka një sipërfaqe të përgjithshme të regjistruar rreth 33 Ari 44 m <sup>2</sup> (3344 m <sup>2</sup> ). AKP ZR Prizren ka dorëzuar në ZKK-Suharekë kërkesë për matje/incizim të gjendjes faktike të NSH Ndërmarrja e pyjeve.  Sidoqoftë, sipërfaqja totale e NSH Ndërmarrja e pyjeve do të përcaktohet saktësisht pas kryerjes së matjeve nga ana e ZKK-Suhareka dhe përditësimit të dhënave kadastrale.
<b>Detyrimet që do të barten</b>	(1) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri.  (2) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:

- a) Është mbledhur gjate periudhës tre mujore qe përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyre ne fuqi;
- b) Qe mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

### Foto nga ajri e Ndërmarrjes së Re



### Informatat

Departamenti i Shitjes  
Agjencioni Kosovar i Privatizimit  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255  
Fax: +381 (0) 38 500 400  
www.pak-ks.org

### Dokumentet e ofertimit

Agjecioni Kosovar i Privatizimit  
Rr: Ilir Konushevc Nr:8  
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së:  
<http://www.pak-ks.org>

